VENDIM
Nr. 10, datë 7.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Marsida Xhaferllari kryesuese;
Fiona Papajorgji anëtare;
Elsa Toska anëtare;
Sonila Bejtja anëtare;
Sandër Beci anëtar;
Ilir Toska anëtar;
Genti Ibrahimi anëtar;
Marjana Semini anëtare,

me sekretare Blerina Basha, në datën 7.3.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (N) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ndue Gjeta

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-738, datë 26.4.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 965, datë 12.5.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 1125, datë 20.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dhënia e pensionit të pleqërisë dhe e pensionit suplementar si ushtarak në përputhje me legjislacionin e kohës.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pikat 1 dhe 2, 5, 15, pika 1, 18, pikat 1 dhe 2, 44, 52, pika 2, 122, pikat 1 dhe 2, 131, shkronjat "a" dhe "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141, pika 2 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 45, 49, pika 3, shkronjat "c" dhe "e" dhe 80, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*) dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH*), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ndue Gjeta ka ushtruar detyrën e ushtarakut në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 30.12.1970–1.8.2003, pas së cilës ka dalë në rezervë dhe është trajtuar me pagesë kalimtare për dy vjet. Prej datës 1.8.2005 ai ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën fillestare 15,693 lekë në muaj.

2. Kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë për kundërshtimin e mënyrës së llogaritjes dhe masës së pensionit të parakohshëm. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 684, datë 6.2.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 899, datë 8.5.2008, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe detyrimin e DRSSH-së, Tiranë të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si dhe t'i paguajë kërkuesit diferencën e masës së këtij pensioni prej datës 1.8.2005 e në vazhdim. Rekursi i ushtruar nga DRSSH-ja, Tiranë nuk është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-96, datë 4.3.2011. Sipas kërkuesit, vendimi gjyqësor përfundimtar i vitit 2008 është ekzekutuar dhe ai ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në vlerën 57,593 lekë, të llogaritur mbi pagën referuese 74,743 lekë.

3. Në vijim, DRSSH-ja, Tiranë me vendimin nr. 2405, datë 19.8.2010, i ka caktuar kërkuesit pension të plotë pleqërie në vlerën 20,189 lekë, kategoria e dytë si ushtarak për një periudhë sigurimi prej 37 vjetësh e 8 muajsh, duke filluar prej datës 8.2.2010. Ky vendim është nxjerrë bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*). Caktimi i masës së pensionit të pleqërisë ka ndikuar në masën e pensionit suplementar të pleqërisë në vlerën 10,276 lekë, pasi sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm", të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), pensioni suplementar është përfitim shtesë që jepet mbi pensionin e pleqërisë dhe llogaritet me 1% të pagës mesatare referuese mujore për çdo vit shërbimi, por jo më shumë se 50% e pensionit të pleqërisë, që përfituesi gëzon në çastin e lindjes së të drejtës për pension suplementar (*nenet 1, 4, 15 dhe 16*).

4. Me kërkesë të kërkuesit, DRSSH-ja, Tiranë me vendimin nr. 2405/1, datë 11.4.2011, ka rishqyrtuar pensionin e pleqërisë nga data 8.2.2010, mbi bazën e koeficienteve të vitit 2010, sipas nenit 59, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993 dhe ka vendosur se kërkuesi përfiton masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi në vlerën 20,552 lekë, duke përfituar njëkohësisht edhe pensionin suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 10142/2009 në masën 50% të pensionit të pleqërisë. Për rrjedhojë, kërkuesi deklaron se ka përfituar 30,828 lekë si shumë e të dy lloj pensioneve.

5. Kërkuesi, me pretendimin se DRSSH-ja, Tiranë ka vepruar në kundërshtim me ligjin, ka ngritur padi në gjykatë, me objekt kundërshtimin e masës së pensionit të pleqërisë, pagimin e diferencave nga zbatimi i keq i ligjit prej datës 8.2.2010, si dhe pagimin e pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 9210, datë 18.3.2004, "Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 9210/2004*) dhe ligjit nr. 9418, datë 20.5.2005, "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9015, datë 11.11.2011, e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Mbi ankimin e veçantë të kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 7, datë 10.1.2012, e ka prishur vendimin dhe e ka dërguar çështjen në gjykatën e shkallës së parë për vazhdimin e gjykimit.

6. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 782, datë 24.1.2014, ka deklaruar moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 1125, datë 20.3.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Sipas gjykatës, e drejta për të përfituar pension të plotë pleqërie kërkuesit i ka lindur në datën 8.2.2010, ndaj në rastin e tij zbatohej ligji nr. 10142/2009, efektet e të cilit kanë nisur të zbatohen në datën 1.7.2009. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk mund të pretendojë përllogaritjen e pensioneve sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimet shoqërore suplementare të Ushtarakëve të Forcave të

Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 8087/1996*), të ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999 (*ligji nr. 8521/1999*) dhe nenit 48 të ligjit nr. 9210/2004, të cilat zbatimin dhe efektet e tyre ligjore i shtrinin deri në datën 30.6.2009.

7. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 965, datë 12.5.2015, por me arsyetim të ndryshëm. Ajo gjykatë ka vënë në dukje se është i pabazuar në ligj shkaku i ngritur në ankim prej kërkuesit se pensioni i pleqërisë nuk duhej llogaritur sipas ligjit nr. 7703/1993. Të gjitha llojet e pensioneve të pleqërisë llogariten sipas skemave të parashikuara në këtë ligj, ndërsa ish-ushtarakët trajtohen edhe me pension suplementar të llogaritur mbi atë të pleqërisë, sipas skemave të parashikuara në legjislacionin e posaçëm për këtë qëllim. Sipas gjykatës, kërkuesi nga data 8.2.2010 përfiton pension maksimal pleqërie në shkallë vendi në vlerën 20,552 lekë, duke përfituar njëkohësisht, sipas ligjit, edhe pensionin suplementar të pleqërisë në masën maksimale të gjysmës së pensionit të pleqërisë.

8. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2022-738, datë 26.4.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Gjykata e Lartë ka evidentuar në vendim se të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs, iu është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka analizuar në mënyrë të hollësishme ligjet nr. 7703/1993 dhe nr. 10142/2009, në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 29.8.2022 kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e të tria niveleve, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe pagesën e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar si ushtarak në përputhje me ligjin material të kohës. Kolegji i Gjykatës në datën 2.11.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar:

10.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat ishin para detyrimit të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë për pagën referuese prej 74,743 lekësh, mbi të cilën duhej llogaritur pensioni i pleqërisë. Paga referuese është një e drejtë e fituar gjyqësisht prej kërkuesit dhe nuk mund të preket. Të drejtat financiare të ushtarakëve kanë qenë objekt gjykimi nga Gjykata, e cila ka theksuar se skema e sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet të pësojë ndryshime përkeqësuese për individin. Gjykata e Lartë ka dalë edhe kundër vendimeve të saj të mëparshme, duke vepruar me dy standarde. Për rrjedhojë, janë cenuar edhe *parimet e pritshmërisë së ligjshme, barazisë në të drejta* dhe *gjësë së gjykuar.*

10.1.2 *Gjykimit të drejtë,* pasi shqyrtimi i çështjes duhej të bëhej në bazë të provave që ekzistonin në datën 8.2.2010, me pagë referuese 74,743 lekë, me të cilën kërkuesi ka dalë në rezervë. Gjykatat nuk kanë zbatuar vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, të Gjykatës së Lartë dhe nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk janë shprehur për mosrespektimin e ligjit nga DRSSH-ja, Tiranë.

10.1.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë pranuar pretendimet e DRSSH-së, Tiranë pa ballafaquar kërkesat e ligjit me provat. Vendimet gjyqësore të dhëna për kërkuesin janë kontradiktore dhe të paplota.

10.1.4 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi procesi gjyqësor ka zgjatur 11 vjet e 13 ditë, prandaj, në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577/2000 i takon dhënia e dëmshpërblimit të drejtë.

10.2 *Parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit,* të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë mohuar në mënyrë arbitrare të gjitha përfitimet që i njeh ligji si ushtarak, sikurse përfitojnë të gjithë ushtarakët e tjerë për natyrën e veçantë të shërbimit.

10.3 *Së drejtës së pensionit,* të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë respektuar formulat e parashikuara nga ligji dhe vendimmarrjet e Gjykatës. Cenimi i pensionit të pleqërisë ka cenuar edhe pensionin suplementar, i cili llogaritet në masën 50% të pensionit të pleqërisë. Vendimet e kundërshtuara cenojnë parimin e hierarkisë së normave në kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Po kështu, është cenuar edhe e drejta për të jetuar, pasi kërkuesi është dëmtuar, denigruar dhe lënë në pozita të vështira jetese.

11. ***Subjektet e interesuara,*** ISSH-ja dhe DRSSH-ja, Tiranë nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit të subjekteve *(locus standi)* që mund t'i drejtohen Gjykatës është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës. Ai ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur për të drejtën dhe masën e pensionit të pleqërisë së tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se procesi gjyqësor ka zgjatur 11

vjet e 13 ditë. Kështu, gjykimi në gjykatën e shkallës së parë ka zgjatur 2 vjet, 11 muaj e 14 ditë, gjykimi në apel ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 18 ditë dhe gjykimi i rekursit ka zgjatur 7 vjet, 2 muaj e 16 ditë, prandaj, në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577/2000 i takon dhënia e dëmshpërblimit të drejtë.

16. Në datën 8.3.2022, kërkuesi ka paraqitur kërkesë me shkrim në Gjykatën e Lartë për "*afrimin e gjykimit të çështjes për masën e pensionit të pleqërisë*". Në datën 29.3.2022, Gjykata e Lartë, në zbatim të nenit 482, pika 4, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka urdhëruar përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes jo më vonë se muaji prill i vitit 2022. Në vijim, relatori i çështjes ka caktuar datën 26.4.2022 për shqyrtimin e rekursit në dhomë këshillimi, datë në të cilën Gjykata e Lartë ka disponuar vendimin e kundërshtuar në ankimin kushtetues.

17. Gjykata evidenton se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 5.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret *(shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi nuk i ka përdorur këto mjete ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe për të kërkuar shpërblim dëmi, ndaj ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim. Për më tepër, kërkesa e tij për "afrimin" e datës së shqyrtimit të rekursit ka rezultuar efektive, pasi Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje dhe ka disponuar me vendim përfundimtar. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkimi për shpërblim të drejtë, i mbështetur në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577/2000, është i pabazuar, pasi kjo dispozitë ligjore lidhet me procesin e gjykimit kushtetues dhe tejzgjatjen e tij.

19. Për sa u takon pretendimeve të tjera, në kushtet kur kërkuesi i ka parashtruar ato përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata çmon se është plotësuar kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

20. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 26.8.2022, pra brenda afatit 4-mujor nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Lartë në datën 26.4.2022, sipas përcaktimit të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

21. Në drejtim të kriterit të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi kundërshton masën e pensionit të pleqërisë të caktuar nga DRSSH-ja, Tiranë nga e cila varet edhe masa e pensionit suplementar të pleqërisë. Sipas tij, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën kushtetuese të pensionit, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykimi nuk ishte i drejtë. Në funksion të këtij pretendimi, kërkuesi argumenton se gjykatat kanë cenuar parimet dhe të drejtat kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor në aspektet e sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme, barazisë në të drejta, gjësë së gjykuar, gjykimit të drejtë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe me barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar respektivisht nga nenet 42 dhe 18 të Kushtetutës.

22. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuesi ka argumentuar se, në ndryshim nga ushtarakët e tjerë, në rastin e tij gjykatat, me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, kanë mohuar në mënyrë arbitrare të gjitha përfitimet e statusit të ushtarakut që atij ia njeh ligji. Gjykata konstaton se në procesin gjyqësor

të kundërshtuar prej kërkuesit gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zgjidhur mosmarrëveshjen për pensionin e pleqërisë së tij, pa i mohuar ose pakësuar masën e ndonjë përfitimi të statusit të ushtarakut. Ndonëse kërkuesi ka kundërshtuar krahas masës së pensionit të pleqërisë, edhe atë të pensionit suplementar, si pjesë e përfitimeve të statusit të ushtarakut, gjykatat janë shprehur për këtë të fundit se ai llogaritet sipas legjislacionit përkatës për këtë qëllim. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme që të mbështesin pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, ndaj ai nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Ndërsa për sa u takon pretendimeve të tjera, në kushtet kur thelbi i argumenteve ka të bëjë me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar vendimmarrjen e tyre pa marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata do t'i trajtojë ato në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të së drejtës substanciale për pension pleqërie. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se këto pretendime hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, ndaj në vijim do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me arsyetimin e tyre kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, në aspektin e gjësë së gjykuar, pasi e kanë përllogaritur masën e pensionit të pleqërisë mbi bazën e një page referuese të ndryshme nga ajo prej 74,743 lekësh e përcaktuar me vendimin gjyqësor përfundimtar të vitit 2008, ndaj paga referuese përbënte të drejtë të fituar. Ndonëse kërkuesit i takonte të merrte pension pleqërie në masën 43,195 lekë dhe pension suplementar të pleqërisë në masën 21,597.5 lekë, gjykatat lanë në fuqi llogaritjet e DRSSH-së, Tiranë respektivisht në vlerat 20,552 lekë dhe 10,276 lekë. Për rrjedhojë, kërkuesi përfiton pension pleqërie dhe suplementar të pleqërisë, gjithsej 30,828 lekë, që bie në kontradiktë dhe është më e ulët sesa masa e pensionit të parakohshëm prej 57,593 lekësh të përfituar prej tij. Paga bazë mbi të cilën u përllogarit pensioni i pleqërisë ishte e ndryshme edhe nga paga bruto edhe nga paga neto në periudhën që kërkuesi ka shërbyer në Forcat e Armatosura.

25. Gjithashtu, ai pretendon se është cenuar parimi i sigurisë juridike në aspektin e mosrespektimit të vendimeve të kësaj Gjykate, e cila në vendimet nr. 9, datë 26.2.2007 dhe nr. 33, datë 24.6.2010 ka kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve që trajtojnë përfitimet suplementare të ushtarakëve dhe ka theksuar se skema e sigurimeve shoqërore nuk duhet të ndryshojë për të përkeqësuar ndjeshëm jetesën e shtetasve që përfitojnë këtë sigurim. Parimi i sigurisë juridike është cenuar edhe për shkak të mosrespektimit të qëndrimit të mbajtur nga Gjykata në vendimet nr. 24, datë 12.11.2008 dhe nr. 21, datë 16.4.2015, në të cilat është pohuar se mosrespektimi i vendimeve përfundimtare gjyqësore cenon parimin e gjësë së gjykuar, gjë e cila sjell edhe cenimin e vetë sigurisë juridike. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka arsyetuar në të kundërt me vendimet e mëparshme që u përkisnin palëve të tjera ndërgjyqëse. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi në këtë ankim kushtetues, janë kontradiktore dhe të paplota.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre,

për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin, si dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Sipas Gjykatës, parimi i gjësë së gjykuar është element themelor i gjykimit të drejtë (*shih vendimet nr. 81, datë 18.12.2017; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me detyrueshmërinë e jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht për forcën detyruese që vendimet e saj kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ndërsa për të drejtën e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

30. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi në datën 8.2.2010 ka mbushur moshën 63 vjeç dhe i është caktuar pension pleqërie i plotë për periudhën e sigurimit prej 37 vjetësh e 8 muajsh, në masën 20,189 lekë, kategoria e dytë si ushtarak. Masa e pensionit është rillogaritur me koeficientet e vitit 2010 dhe përfundimisht, kërkuesit i është caktuar pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi në masën 20,552 lekë. Përllogaritja e pensionit nga DRSSH-ja Tiranë është kontrolluar në rrugë gjyqësore dhe është vlerësuar në përputhje me ligjin. Konkretisht, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ka argumentuar se pensioni i pleqërisë llogaritet mbi bazën e skemave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 7703/1993, ndaj ligjet e veçanta për përfitimet suplementare të statusit të ushtarakut nuk janë të zbatueshme për këtë lloj pensioni. Gjykata e Lartë në vendimin e mospranimit të rekursit është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit ka analizuar në mënyrë të hollësishme dispozitat e ligjeve nr. 7703/1993 dhe nr. 10142/2009.

31. Gjykata konstaton se kërkuesit i është njohur e drejta e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me vendim gjyqësor përfundimtar të vitit 2008 dhe si rezultat i ekzekutimit të tij, atij i është caktuar masa e pensionit të parakohshëm 57,593 lekë, e llogaritur mbi pagën referuese 74,743 lekë. Vendimi gjyqësor i vitit 2008 ka pasur në objekt të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, që përbën një prej përfitimeve suplementare të ushtarakëve. Në këtë mënyrë,

në dhënien e vendimit përfundimtar të vitit 2008, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përcaktuar faktin se kërkuesi kishte qenë ushtarak dhe kishte dalë në pension të parakohshëm në datën 1.8.2005 dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen, duke zbatuar dhe interpretuar ligjin nr. 8087/1996 (*sipas ndryshimeve në kohën e përfitimit të së drejtës*) dhe ligjin nr. 9210/2004 (*për statusin e ushtarakut*).

32. Duke iu referuar përmbajtjes së ligjit nr. 8087/1996 në vitin 2005, Gjykata vëren se ushtaraku që dilte në rezervë ose lirim pas datës 3.7.1991, gëzonte të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie. Kjo e drejtë varej nga vitet e vjetërsisë së shërbimit si ushtarak (sipas gjinisë), ndërsa masa caktohej: (a) 50 për qind të pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi; (b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit, masa e pensionit shtohej me 2 për qind të pagës referuese (*neni 11*). Sipas këtij ligji, "paga referuese" është paga bazë për funksionin dhe shpërblimi për gradën ushtarake në kohën e daljes në rezervë ose lirim. Në rastin e kërkuesit, si ushtarak që ka dalë në rezervë pas hyrjes në fuqi të ligjit ndryshues nr. 8521/1999, paga bazë ishte ajo e kohës së lindjes së të drejtës së përfitimit (*neni 7*). Në të njëjtën linjë, ligji nr. 9210/2004 (*për statusin e ushtarakut*), parashikonte të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët me vjetërsi shërbimi të paktën 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, si pjesë të statusit të ushtarakut, në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë, duke përcaktuar se për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e vjetërsisë, jepej një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore (*neni 35*).

33. Ndërkohë, në procesin gjyqësor të përfunduar në vitin 2022, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me vendimet e kundërshtuara në ankimin kushtetues kanë zgjidhur mosmarrëveshjen për masën e pensionit të pleqërisë, bazuar në ligjin nr. 7703/1993, sikundër edhe për masën e pensionit suplementar të pleqërisë bazuar në ligjin nr. 10142/2009. Ligji nr. 7703/1993, në kohën e daljes në pension pleqërie të kërkuesit, parashikonte se personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të plotë me mbushjen e një moshe të caktuar dhe plotësimin e viteve të duhura të sigurimit (*nenet 31 dhe 92*). Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga: i. shuma bazë, e cila duhet të sigurojë standardin minimal të jetesës; ii. dhe shtesa 1 për qind për vit sigurimi, e përllogaritur mbi bazën mesatare të vlerësueshme nëpërmjet kontributeve dhe e indeksueshme çdo vit (*neni 32*). Ndërkohë, baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Ligji përcakton detajet e llogaritjes së bazës së vlerësuar në varësi të periudhave të sigurimit: i. para datës 1.1.1994; ii. pas datës 1.1.1994; iii. para dhe pas datës 1.1.1994 (*neni 59*).

34. Gjykata thekson se pensioni i pleqërisë garantohet nga neni 52 i Kushtetutës, si pjesë e së drejtës kushtetuese për sigurime shoqërore, sipas një sistemi të caktuar me ligj. Konkretisht sistemi i sigurimeve shoqërore është caktuar me ligjin nr. 7703/1993, i cili rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore dhe u siguron të punësuarve, ndër të tjera, edhe të ardhura për periudhën e pleqërisë. Kjo do të thotë se pavarësisht statusit specifik që individi ka për shkak të detyrës së ushtruar, përfitimi i pensionit të pleqërisë i nënshtrohet sistemit të përcaktuar nga ligji nr. 7703/1993.

35. Për sa më lart, pensioni i pleqërisë është i ndryshëm nga përfitimet suplementare të ushtarakut, në të cilat përfshihet edhe pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Ndryshimi midis tyre lidhet jo vetëm sepse ato përfitohen nga ligje të veçanta, por edhe skema ligjore e përllogaritjes së secilës prej tyre, që siç u shpjegua më lart, është e ndryshme, sidomos në drejtim të referencës, mbi të cilën përllogaritet lloji i pensionit – mesatares së pagave të elementit "shtesë" për pensionin e pleqërisë dhe pagës referuese (pagës bazë në momentin e lindjes të së drejtës së përfitimit) për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

36. Fragmentarizimi ligjor dhe skemat e ndryshme duket se janë shkaku i rezultatit të ndryshëm për kërkuesin, sipas të cilit ai ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masë më të lartë se sa shuma e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar të pleqërisë së bashku. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se skemat e sigurimeve shoqërore dhe ato të përfitimeve të statusit të zyrtarëve të ndryshëm janë pjesë e politikave shtetërore, për të cilat ligjvënësi ka diskrecion. Megjithatë, vlerësimi i përputhshmërisë së skemave nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues dhe nuk është kundërshtuar as nga kërkuesi. Për sa i takon këtij të fundit, Gjykata vë në dukje se në ankimin kushtetues individual ai nuk ka ngritur ndonjë pretendim kushtetues për përmbajtjen e nenit 16 të ligjit nr. 10142/2009, sipas të cilit pensioni suplementar i pleqërisë nuk mund të jetë më i lartë se 50% i pensionit të pleqërisë.

37. Për sa më lart, Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor përfundimtar i vitit 2008 nuk përbën "gjë të gjykuar" për pensionin e pleqërisë dhe pensionin suplementar të pleqërisë së kërkuesit, pasi ai ka vendosur për një mosmarrëveshje tjetër gjyqësore, me objekt "të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi" dhe shkak ligjor "veprimet e parregullta të DRSSH-së, Tiranë në llogaritjen e tij sipas ligjit nr. 8087/1996, i ndryshuar". Me fjalë të tjera, "paga referuese" prej 74,743 lekësh që është përcaktuar në zbatim të këtij vendimi gjyqësor përfundimtar është element i skemës së llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 8087/1996, i zbatueshëm në kohën e lindjes së kësaj të drejte. Nga ana tjetër, kjo "pagë referuese" nuk është element i skemës ligjore të llogaritjes së pensionit të pleqërisë sipas ligjit nr. 7703/1993. Po kështu, kjo "pagë referuese" nuk është e njëjtë as me përcaktimin e saj dhe skemën ligjore të llogaritjes së pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 10142/2009, për më tepër kur, sipas këtij ligji, ky pension suplementar nuk mund të jetë më shumë se 50% e pensionit të pleqërisë, që përfituesi gëzon në çastin e lindjes të së drejtës për pension suplementar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me vendimet e kundërshtuara kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në aspektin e "gjësë së gjykuar" dhe së drejtës së fituar është i pabazuar.

38. Në vijim, Gjykata vëren se vendimet e saj të mëparshme nr. 9, datë 26.2.2007, nr. 33, datë 24.6.2010 dhe nr. 81, datë 18.12.2017, të cilat janë referuar nga kërkuesi, kanë pasur në objektin e tyre vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve të nxjerra nga organet publike (ligje dhe vendime gjyqësore), të cilat rregullonin përfitimet suplementare të ushtarakut për shkak të statusit të veçantë të tij të rregulluar me ligj, por nuk kanë rregulluar në mënyrë specifike të drejtën për pension pleqërie. Në këtë situatë, Gjykata, me të njëjtin arsyetim si më lart, çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi kjo jurisprudencë kushtetuese nuk lidhet drejtpërdrejt me skemat e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar të pleqërisë.

39. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë të paplota dhe kontradiktore, pasi nuk përputhen me provat e shqyrtuara, fillimisht duhet evidentuar se gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por me arsyetim të ndryshëm, ndaj Gjykata do të analizojë respektimin e standardit të arsyetimit nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Nën këtë analizë, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim dhe kanë disponuar nëpërmjet vendimmarrjes vlerësimin e tyre lidhur me pretendimet e kërkuesit të paraqitura në ankim dhe rekurs, përfshirë edhe atë që lidhet me vendimin gjyqësor përfundimtar të vitit 2008. Gjykata e apelit ka vënë në dukje se kërkuesi ka përmbushur kriteret për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 8.2.2010 dhe se masa e pensioneve të pleqërisë dhe suplementar të pleqërisë janë bazuar respektivisht në skemat e ligjit për sigurimet shoqërore dhe ligjit për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve. Ndërsa, Gjykata e Lartë është shprehur se të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs, iu është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e

gjykatës së apelit, e cila ka analizuar në mënyrë të hollësishme dispozitat e ligjit nr. 7703/1993 dhe ligjit nr. 10142/2009 dhe se ky qëndrim bazohet edhe në jurisprudencën e vetë kësaj gjykate.

40. Për sa më lart, Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, si dhe vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit, që ka ndryshuar arsyetimin e asaj të shkallës së parë, paraqiten të rregullta në formë, të qarta, koherente, të plota dhe pa kundërthënie, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsyetimit.

41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për pension pleqërie

42. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për pension, e garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë respektuar formulat e parashikuara nga ligji dhe vendimmarrjet e Gjykatës. Sipas tij, cenimi i pensionit të pleqërisë i ka cenuar edhe pensionin suplementar, pasi ky i fundit, sipas ligjit, llogaritet në masën 50 % të pensionit të pleqërisë. Vendimet e kundërshtuara cenojnë parimin e hierarkisë së normave në kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Gjithashtu, kërkuesi parashtron se cenimi i së drejtës së pensionit i ka cenuar edhe të drejtën për të jetuar, pasi është dëmtuar, denigruar dhe lënë në pozita të vështira jetese.

43. Kushtetuta, në nenin 52, pika 1, të saj, ka parashikuar se kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

44. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se e drejta e pensionit përfshihet në grupin e të drejtave ekonomike sociale, të cilat për nga natyra e tyre janë të drejta pozitive. Prandaj, përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar *(shih vendimet nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata evidenton se neni 52 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën themelore për sigurime shoqërore në pleqëri të kujtdo, duke marrë në mbrojtje individin për t'i siguruar atij mjete jetese në formën e mbështetjes ekonomike nga shteti, kur ai është në moshën e pleqërisë ose kur është i paaftë për punë. Këto situata vulnerabiliteti të individit, në thelb, nuk varen prej vullnetit të tij. Kjo do të thotë se shteti, në mënyrë të detyrueshme, nëpërmjet politikave të tij sociale, aktivizohet për të marrë masa që t'i garantojë individit mbrojtje pozitive, në formën e përfitimeve financiare, ku bën pjesë edhe pensioni i pleqërisë. Masat e ndërmarra nga shteti, si pjesë e politikave sociale të tij, duhet të ofrohen në mënyrë vazhduese, me qëllim gëzimin e pandërprerë të tyre nga individët dhe ruajtjen e një standardi të caktuar të mjeteve të jetesës.

46. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës për pension bazohet në vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj është i ndërvarur nga pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Në kushtet kur ky pretendim i fundit u vlerësua i pabazuar (*shih paragrafin 41 të vendimit*), Gjykata çmon se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për pension nuk qëndron.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.3.2023.
Shpallur më 5.4.2023.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari
Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahimi